



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:085060

Datë: 19.07.2019

Numri i dokumentit: 00418193

C.nr.1009/15

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm , gjyqtari Ilir Berisha, me sekretaren juridike Ferka Kalaq, në kontestin e KP, Pejë te cilën e përfaqëson me autorizim av. D. S.- G., kundër të paditurit S. M. nga Peja, ..., te cilin e përfaqëson sipas autorizimit M. K., për shkak të pasurimit të pabazë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **19.07.2019**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses KP Pejë, përmes të cilës kanë kërkuar që të “detyrohet i padituri S.M. nga Peja, që në emër të borxhit ndaj paditëses t’ia paguaj shumën prej nga **2.653.78 euro euro**, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **si tërësisht e pabazuar.**

II. Obligohet paditësja që t’ia paguajë shpenzimet procedurale të paditurit dhe atë në lartësi prej **405,00 euro**, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja KP Pejë te cilën e përfaqëson me autorizim av. D. S.- G., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, e te precizuar me date 05.04.2019, kundër të paditurit S. M. nga Peja, lagja “....”te cilin me autorizim e përfaqëson av. M. K. nga Peja, për shkak të pasurimit të pabazë, në të cilën ka theksuar se i padituri pa baze ligjore ka pranuar për 8 muaj pas pensionimit ne periudhën kohore prej 30.06.2014 e gjere me 31.12.2015 pagën mujore ne shumen prej 267.51 euro- netto duke realizuar kështu te hyra ne shumen e përgjithshëm prej 2.653.78 euro.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e autorizuar e paditëse av. D. S.- G. nga Prishtina, ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe precizimit te saj dhe parashtrimeve te theksuara ne seancat gjyqësore. I aut. I paditëses njofton gjykatën se i padituri ka qene i punësuar ne Komunën e Pejës, Drejtorinë për Bujqësi Pylltari dhe Mikroekonomi mirëpo me dt. 22.03.2013 është lidhur një memorandum mirëkuptimi për transferim te kompetencave për mbrojtjen e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, Mali i Share ne territorin e Komunave Pejë, Deçan, Istog, Gjakove dhe ky memorandum është lidhur në mes Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ministrisë se Financave, Ministrisë e Administratës se Pushtetit Lokal dhe komunave te lartcekura ku te behet transferi i kompetencave, burimeve njerëzore burimeve financiare, inventarit dhe asetëve nga Komuna ne Drejtorin për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna ne Pejë, e cila nen ombrellën e Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Me dt. 25.02.2014 është

bere një procesverbal për pranim dorëzimin e këtyre kompetencave dhe pasi që i padituri S. M. ishte ne pozitën roje pylli ne njësinë Komuna e Pejës – Drejtoria për Bujqësi , Pylltari dhe Mikroekonomi nuk ka qene e obliguar te lëshoi vendim mbi pensionimin e te paditurit. I aut. I paditëses, konsideron se me provat e paraqitura ne padi dhe gjate shqyrtimit gjyqësor padyshim janë vërtetuar gjendja faktike dhe është vërtetuar me prova bindëse dhe dokumentuese si ato personale po ashtu prova materiale se i padituri S. M. nga Peja, Lagja “...” nr. 12, është pasuruar pa baze ligjore. Përkatësisht i padituri edhe përkundër asaj se ka arritur moshën e pensionimit me datën 05.04.2014, dhe duke e ditur se nuk ka te drejte ne page i njëjti me vetëdije te plote nuk ia kthen vullnetarisht vullnetarisht paditësit pagat e pranuaras përmes xhirollogarisë bankare pa baze ligjore për tete (8) muaj pas pensionimit, ne periudhën kohore prej 30.06.2014 gjere me date 31.12.2015, me këtë duke u pasuruar pa baze ligjore ne shumen prej 2.653.78 euro.

Andaj konsideron se bazuar ne prova te cilat gjenden ne shkresat e lendes ne tërësi është vërtetuar baza juridike dhe lartësia e saj, dhe njehë rit bazuar ne ligj besojnë se gjykata ka prova te mjaftueshme qe te paditurin ne emër te pasurimit te pabaze t’ia paguaj paditëses shumen prej 2.653.78 euro me kamate ligjor prej 8% ne vit.

Po ashtu ne emër të shpenzimeve procedurale paditësja kërkon nga gjykata qe ta detyroj te paditurin qe paditëses t’ia paguaj shumen prej 832,00 euro.

I paditurit nuk kanë parashtruar përgjigje në padi, ndërsa gjatë shqyrtimeve të mbajtur i autorizuari i tyre av.M.K. nga Peja, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa në fjalën përfundimtare të cilën gjykatës i ka dorëzuar me shkrim, ka theksuar se qe të mund te parashtrohet një kërkesë si e paditëse duhet te ekzistoj jo vetëm kushtet ligjore siç janë pasurimi i pabaze i njëjës pale dhe dëmtimi i palës tjetër por edhe mos ekzistimi i kauzës mbi te cilën do et bazohet pasurimi i pabaze. Nëse dikush dëshiron te jet i dëmtuar (volenti non fit in jura) ai me vone nuk mund te thirret ne atë se i takon e drejta ne kthim te asaj çka tjetri ka përfituar me pëlqimin e paguesit. Pala e cila ka paguar dhe nuk ka qene e detyruar nga askush qe te jet ne lajthim apo te tregoj pakujdesi ne veprimet e veta konsiderohet se ka dhënë pëlqimin qe et dëmtohet sepse me vullnet e ka kryer pagesën. Lajthimi ne rastin konkret ka qene i paarsyeshme sepse askush nuk e ka penguar e as detyruar qe te ketë kujdesin profesional ne kryerjen e punëve (bonus pater familias). Tutje i aut. I te paditurit thekson se nëse veprimet e punëtorëve te paditëses, ka lëshime e cila Komunës i ka shkaktuar dem, atëherë përgjegjësinë e mban Komuna me punëtorin e saj. kjo do te thotë se nuk ka arsyesh mëri dhe baze te lajthimit te punëtorit kur e ka kryer pagesën, sepse kane qene ne dijeni për pensionimin e te paditurit. Te gjitha këto i aut. Paditurit i bazon ne nenin 195 te LMD-së, sipas se cilit nen paditësja nuk ka te drejte te kërkon kthimin e sendeve ta paguara. Duke pasur parasysh të thënat dhe të dhënat e lartcekura, gjykatës i ka propozuar që pas vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë në shumen prej 475,00 euro. *(më gjërësisht si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim).*

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e **pa bazuar**.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqësve si në vijim: listat e pagave për te paditurin S. M. për muajin maj 2014 deri ne dhjetor 2014, marrëveshja mbi kthimin e mjeteve financiare e datës 01.10.2015 me numër 01-400-125050, shkresa e Drejtorise për Buxhet dhe Financa drejtuar Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi e dt. 04.02.2015 për heqjen nga lista e pagave

për të paditurin S. M., kërkesa e paditëses KP me nr. 540/15 te dt. 2010.2015 drejtuar përmbauesit privat Z. B., njoftimi për pensionimin e të paditurit S. M. i datës 26.03.2014 i drejtuar nga udhëheqësi i personalet M. K. drejtuar KP -DBPH procesverbali i dt. 25.03.2014 lidhur me pranimit dorëzimit e dosjeve personale te punëtorëve te DBPH te cilët kane kaluar ne Drejtorinë për administrimin e parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna, procesverbali ik agjencisë se Kosovës për mbrojtjen e mjedisit me nr. 136/AMMK/2014, lista e personelit qe do të kaloj nga Drejtoria Komunale ne Pejë, ne Drejtorin për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, formulari për regjistrimin e inventarit, vendimi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit për emërimin e komisionit për pranimit dorëzimit e stafit, mjeteve buxhetore, aseteve, inventarit dhe materialit zyrtar nga niveli lokal i Komunës se Pejës, ne nivelin qendror Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna me nr. 130/AMMK/2014 te datës 24.02.2014, memorandumit i mirëkuptimit it i lidhur

Ne mes te institucioneve e nivelit qendror lokal i dt. 19.03.2013 për transferimin e kompetencave për mbrojtjen e parqeve kombëtare, lista e pagave te te paditurit S. M. për muaj mars 2014, kartela për nëpunësin S. M. për datën janar 2014 deri me datën dhjetor 2019, dosja personale e të paditurit S. M., gjendja e llogarisë bankare e dt. 01.01.2014 deri me datën 01.02.2016 për te paditurin S. M..

Nga leximi i listave te pagave për të paditurin S. M. për muajin maj 2014 deri ne dhjetor te vitit 2014 vërtetohet fakti se te paditurit ne listën e pagave i kane figuruar se ka marr pagën ne shumen prej 267.51 euro netto dhe shuma prej 290.98 euro brutto.

Nga leximi i marrëveshjes mbi kthimin e mjeteve financiare e datës 01.10.2015 me numër 01-.... të cilën paditësja ka kërkuar nga i padituri shumen e marr prej 2.618,80 euro ne emër te pasurimit te pabaze e qe ne afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve ne këste te njëjta mujore ne lartësi prej 145.50 euro ne muaj dhe atë duke filluar nga dita e lidhjes se kësaj Marrëveshje (01.05.2015), me te cilën vërtetohet fakti se kjo marrëveshje nuk është arritur ne mes te paditësit dhe te paditurit kjo nga fakti se kjo marrëveshje nuk është e nënshkruar.

Nga leximi i shkresës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa drejtuar DBPH dt. 04.02.2015 për heqjen nga lista e pagave për të paditurin S. M., vërtetohet fakti se kjo drejtori ka kërkuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa qe i padituri S. M. te hiqet nga lista e pagave meqenëse i njëjti ka vazhduar te figuroj ne listën e pagave edhe pasi qe është pensionuar e për te cilën gjë ka qene e njoftuar me kohe Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe se MPHMM nuk ka vepruar ne këtë drejtim.

Nga leximi i shkresës së kërkesa e paditëses DB me nr. 540/15 te dt. 2010.2015 drejtuar përmbauesit privat Z. B., njoftimi për pensionimin e të paditurit S. M. i datës 26.03.2014 i drejtuar nga udhëheqësi i personalet M. K. drejtuar DBPH me të cilën kërkesë thuhet se i padituri ka dëmtuar Buxhetin e Kosovës ne shumen prej 2.909.80 euro dhe atë duke pranuar nëntë paga pasi qe është pensionuar i njëjti është pensionuar me dt. 05.04.2014, andaj kërkon qe i padituri te bej kthimin e nëntë pagave te cilat i ka marr ne shumen totale te fitimit prej 2.909.80 euro, që t'ia kthej Komunës se Pejës.

Nga leximi i shkresës së njoftimi për pensionimin e të paditurit S. M. i datës 26.03.2014 i drejtuar nga udhëheqësi i personal M. K. drejtuar DBPH me et cilin njoftim vërtetohet fakti se i padituri me dt. 05.04.2014 ka arritur moshën e pensionit dhe se me këtë është njoftuar Drejtoria për Pylltari dhe Hidroekonomi.

Nga leximi i procesverbalit i dt. 25.03.2014 lidhur me pranim dorëzimit të dosjeve personale të punëtorëve të DBPH të cilët kanë kaluar në Drejtorinë për administrimin e parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna, vërtetohet fakti se i padituri është në listën e stafit të cilët kanë kaluar në kompetencë nga Drejtoria Komunale në Pejë në Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në Pejë.

Nga leximi i shkresës procesverbalit të agjencisë së Kosovës për mbrojtjen e mjedisit me nr. 136/AMMK/2014, vërtetohet fakti është me dt. 24.02.2014 është formuar komisioni për dorëzimin – pranimin e stafit të zyrtarëve, jetëve buxhetore, aseteve, inventarit dhe materialit zyrtar lokal- Komuna e Pejës në nivel qendror.

Nga leximi i memorandumit të mirëkuptimit të lidhur në mes të institucioneve të nivelit qendror lokal i dt. 19.03.2013 për transferimin e kompetencave (burimeve njerëzore, inventarit dhe aseteve), për mbrojtjen e parqeve kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Mali Sharr” në territorin e Komunave Pejë, Deçan, Istog, Gjakovë, Junik dhe Dragash, vërtetohet fakti se është bërë transferimi i këtyre kompetencave.

Nga leximi i listës së pagave të datës janar 2014 deri me datën dhjetor 2019 të lëshuar nga “N...” – Banka, vërtetohet se i padituri nga data 30.04.2014 e deri me datë 30.01.2015 ka pranuar në llogarinë e tij bankare nëntë paga dhe atë pagën në shumën prej 267.51 euro – netto.

Nga gjendja faktike gjykata e vërtetoj faktin se i padituri nga paditësja ka pranuar gjithsej 267x9 në shumën prej 2407.59 euro. Përkundër faktit se paditësja nuk e kishte një detyrim ndaj të paditurit pasi që ai ishte transferuar në marrëdhënie pune në institucion tjetër, këto mjete e njëjta të paditurit ia kishte bartur me lëshimin e saj, pa qene e detyruar apo e shtyre nga i padituri.

Se kërkesë padia e paditëses është e pabazuar këtë e ka përcaktuar dispozita e nenit 195 të LMD-së e cila ka përcaktuar se “Kush kryen pagesën duke ditur se nuk e ka për detyrë ta paguaje nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin, përveç nëse e ka rezervuar të drejtën e kërimit të kthimit, apo qofte se e ka paguar për t’iu shmangur dhunës”, andaj në rastin konkret paditësja (Komuna e Pejës) duke mos qene as në lajthim faktik e as juridik, ka bërë këto pagesa sepse ka qene në dijeni për bartjen e kompetencave si ato të aseteve, financiare, të burimeve njerëzore etj, në institucion tjetër (shif memorandumit të mirëkuptimit të lidhur në mes të institucioneve të nivelit qendror lokal i dt. 19.03.2013, si dhe nga procesverbalit i dt. 25.03.2014) ,që do të thotë e ka kryer me vullnet dhe duke mos qene në ndonjë kërcënim të personit tjetër të cilit i është bërë pagesa..

Meqenëse me asnjë provë paditësja nuk ka mundur të vërtetojë faktin se për pagesat e bëra ndaj të paditurit të këtë rezervuar të drejtën e kthimit apo pagesën ta këtë bërë me qëllim të shmangët dhunës, me ç ‘rast gjykata nuk mund të ofroj mbrojtje gjyqësore paditëses.

Përfundimisht gjykata vlerëson se i padituri nuk ka ndonjë obligim ndaj këtu paditëses, për arsye të cekura më lartë, andaj kjo gjykatë nuk mund të aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, respektivisht të njëjtën e refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe nenit 463.1 të LPK-së, pasi që pala paditëse e ka humbur kontestin, gjykata ia ka njohur shpenzimet e procedurës të paditurit në shumën prej 405,00 euro, dhe atë në emër të përgjegjës në padi shumën prej 135,00 euro, mbajtjes së dy seancave gjyqësore në shumën prej 270.00 euro, pasi që këto kanë qene shpenzime të domosdoshme në procedurë.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.1009/15 datë 19.07.2019

Sekretarja juridike
Ferka Kalaq

**Gjyqtari
Ilir Berisha**

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate